



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.580/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Burim Qestaj me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.580/2021 i paraqitur nga Burim Qestaj me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 31.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Burim Qestaj me vendbanim në Gjermani në të cilin pretendon se KQZ, nuk e ka përfshirë në listat e votuesve jashtë vendit pasi që i njëjti ka aplikuar me email të Isuf Qestaj-axhës së tij.

Parashtruesi i apelit, apeli i ka bashkangjitur emailin nga KQZ, formularin e aplikimit për Burim Qestaj dhe dokumentin identifikues/ letërnjoftimin.

Me datë 01.09.2021 PZAP, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se, Siç shihet edhe në ankesat paraprake të aplikuesve me mbiemër Qestaj me vendbanim në Zvicër, e njëjta e-mail adresë ka dërguar aplikacione për personat me mbiemrin Qestaj, që kanë vendbanim në shtetin Gjermanisë. Si të tilla, dërgimi i aplikacioneve për regjistrim pavarësisht se është i njëjti mbiemër, e që janë dërguar nga e-mail adresa "isuf_qestaj@outlook.com" nuk konsiderohet rreth i ngushtë familjarë, për shkak që të gjitha aplikacionet e dërguara tashmë nga ky e-mail, janë aplikacione për persona që kanë vendbanim në Zvicër dhe Gjermani, e në data bazën e aplikimit për regjistrim, rezulton se është edhe një mbiemër Qestaj, me vendbanim në Suedi.

Të gjitha këto aplikacione për regjistrim janë refuzuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit Burim Qestaj gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka bërë aplikim për

regjistrim përmes axhës së tij Isuf Qestaj, dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi me të cilin e vërteton faktin se axha i tij Isuf Qestaj ka pasur autorizim siç pretendon në apelin e tij për të aplikuar në emër të apeluesit. Paneli gjithashtu ka konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë për persona me mbiemër të njëjtë dhe që kanë vendbanim të njëjtë kjo nuk e vërteton faktin se të njëjtit janë rreth i ngushtë familjar pasi që në rastin konkret nuk është ofruar asnjë provë që dëshmon se të njëjtit janë në afërsi të tillë familjare për ta provuar faktin e rrethit të ngushtë në familje siç kërkohet në nenin 2 pika 2.1 të udhëzimit administrativ nr. 02/2021, andaj ky apel nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar prova shkresore lidhur me pretendimet e paraqitura si më lartë, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thëniet e tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë, se KQZ-ja me rastin e mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë vendit ka bërë ndonjë shkeljeve eventuale të procedurës.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Burim Qestaj nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 580/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevci



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.